

# MËSIMI SHTATË

## Trajtimi i kundërshtimit ndaj ndryshimit

Kudo ku ka jetë, ka nevojë për ndryshim—dhe kurdoherë që dikush sugjeron ndryshim, dikush tjetër do ta kundërshtojë atë në mënyrë të pashmangshme. Ndërsa sheh te libri i Veprave dhe tek ai i Nehemias për të marrë udhëzime, Alistair Begg-u eksploron arsyet pse njerëzit i rezistojnë ndryshimit, si edhe hapat që udhëheqësit mund të hedhin për të sjellë ndryshim dhe për ta trajtuar kundërshtimin.

### Shënime

#### Hyrje

---

---

---

---

#### Pse i rezistojnë njerëzit ndryshimit

---

---

---

---

---

#### Pse reagojnë njerëzit ndaj ndryshimit

---

---

---

---

---

#### Mposhtja e kundërshtimit ndaj ndryshimit

---

---

---

---

---

---

## SHKRIME KYÇ

“Por në ato ditë, duke u shumëzuar numri i dishepujve, u bë një murmuritje nga ana e helenistëve kundër hebrenjve, sepse vejushat e tyre po lireshin pas dore në shërbesën e përditshme.” (Veprat 6:1)

“Kështu, në mbarë Judenë, në Galile dhe në Samari kishat kishin paqe dhe ndërtoheshin. Dhe duke ecur në druajtjen e Zotit dhe në ngushëllimin e Frymës së Shenjtë, shumëheshin.” (Veprat 9:31)

## Vështrim në thellësi

1. *“Kemi nevojë t’i njohim njerëzit tanë dhe kemi nevojë të zhvillojmë marrëdhënie mirëbesimi me ta. Kjo mund të arrihet vetëm me kalimin e kohës.”*

Është gabim shumë i rëndë të përpiqesh të sjellësh ndryshim në një shërbesë pa i njohur, së pari, njerëzit tuaj dhe pa fituar mirëbesimin e tyre. Cilat janë disa prej gjërave që mund të bëni, të cilat mund të krijojnë një mirëbesim më të madh nga ana e njerëzve tuaj?

---

---

---

---

---

---

2. *“Më mirë të mos provojmë asgjë, sesa të dështojmë. Prandaj, duke qenë se jemi tepër të tiranizuar nga mundësia e dështimit, ne thjesht nuk bëjmë asgjë. Ky mund të jetë faktor po aq paralizues në përjetimin e një udhëheqësi, sa mund të jetë edhe një faktor dobësues tek ata që po reagojnë ndaj udhëheqjes.”*

Frika nga dështimi është një pengesë e kuptueshme në zbatimin e ndryshimit. Megjithatë, ka situata të caktuara në të cilat ia vlen të rrezikosh. Cilat janë disa zona të shërbesës suaj në të cilat ia vlen të rrezikoni në përpjekjen për të sjellë ndryshim? Çfarë po ju pengon që të ndërmerrni veprimin e nevojshëm?

---

---

---

---

---

---

3. “Ne e mbitheksojmë atë që mund të bëjmë në një vit, dhe e nënvlerësojmë atë që mund të bëjmë në pesë vjet. Ja pse ndryshimi duhet të jetë gradual.”

Ndryshimi duhet të ndodhë ngadalë dhe me një perspektivë afatgjatë në mendje. Nëse jemi të paduruar në zbatimin e ndryshimit, ka të ngjarë që do t'i minojmë vetë ndryshimet e dëshiruara, para se atyre t'u jepet mundësia që të ndodhin. Vlerësoji ndryshimet që dëshiron të shohësh në shërbesën tënde gjatë pesë vjetëve në vazhdim. Si mund t'i zbatosh ato gradualisht?

---

---

---

---

---

---

## Mënyra për t'u lutur

- Lutu që Zoti të të japë një dashuri më të madhe për njerëzit e tu, që ata të mund ta dallojnë se ti je një bari i cili kujdeset dhe jo thjesht një strateg shërbese.
- Kujtoja vetes dashurinë që Perëndia ka për ty në Krishtin, dhe lutu që gjithnjë e më shumë të prehesh i sigurt në pranimin e Tij. Pastaj kërkoji Zotit të të ndihmojë që ta mposhtësh frikën nga dështimi dhe të të japë edhe kurajën për të ndërmarrë rreziqet e duhura në shërbesë për lavdinë e emrit të Tij.
- Lutu që zemrat e atyre të cilëve u shërben, të mund të zbuten ndaj mësimit të Shkrimit, që ata të jenë të gatshëm ta pranojnë çfarëdo që mund t'u thotë Bibla, sidomos në zonat ku nevojitet ndryshim.